



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE
PLATFORMËS SË BASHKËQEVERISJES

Nr.8265/1 prot.

Tiranë, më 03.09.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Anthokli Bane
Konckë, Zagori
Gjirokastrë

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 8265 prot., datë 20.08.2024, lidhur me vërtetimin e pensionit, i cili lëshohet nëpërmjet portalit e-Albania, ju informojmë se:

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, duke filluar nga data 1 maj 2022, të gjitha shërbimet që ofron Instituti i Sigurimeve Shoqërore, realizohen nëpërmjet aplikimit on-line, të qytetarëve, në platformën e-Albania.

Një nga këto shërbime që ISSH ofron është edhe “Vërtetim pensioni”, i cili u mundëson pensionistëve të marrin on-line, në momentin e aplikimit, vërtetimin e përfitimit, mujor korent, të pensionit, me vulë elektronike, me vlerë të plotë ligjore.

Në formatin e standartizuar të vërtetimit të pensionit mujor janë të vendosura rubrikat si: lloji i pensionit, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, masa mujore në vlerë leku, qendra paguese, destinacioni për brenda ose jashtë shtetit, data e fillimit të pensionit etj...

Në rubrikën “masa mujore në vlerë leku” të këtij formati, vendoset totali i të ardhurave aktuale që pensionisti përfiton nëpërmjet skemës së sigurimeve, në muajin korrent, ku përfshihen: masa aktuale e pensionit + kompensimet e ndryshme të përfituara, në bazë të VKM-ve, për kompensimet e pensioneve.

Gjithashtu, duhet t’ju bëjmë me dije se, referuar sistemit të pagesës së pensioneve (PCAMS), nuk rezultoni të jeni përfitues i kompensimeve të energjisë elektrike në pension sipas Vendimit të

Këshillit të Ministrave nr. 565, datë 09.08.2006 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 14.01.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj".

Me vendim caktimi pensioni nr. 1663, datë 09.11.2015, jeni përfitues i pensionit të pleqërisë në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë, me datë lindje të së drejtës 01.11.2015, me datë fillimi pensioni 01.04.2018, me masë fillestare pensioni 19,614 lekë në muaj.

Ky pension ka përfituar të gjitha indeksimet ndër vite sipas Vendimeve të Këshillit të Ministrave "Për indeksimin e pensioneve" dhe aktualisht është **në masën 27, 036 lekë në muaj**.

Bashkëlidhur kësaj përgjigje do të gjeni vërtetimin mujor të pensionit, për jashtë shtetit.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!